

RAPORT STUDIMOR

INFORMIMI, NJOFTIMI DHE KONSULTIMI PUBLIK NGA PUSHTETI VENDOR

BASHKIA KORÇË



GRUAJA NË ZHVILLIM KORÇË
QERSHOR 2022

Tabela e përmbajtjes

Hyrje.....	3
Lista e shkurtimeve	4
Profili i Bashkisë Korçë	5
Metodologjia.....	7
Analizë e formave të njoftimit, informimit dhe konsultimit publik	8
Gjetjet nga anketimi me përfaqësuesit e Bashkisë dhe përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak	13
Konkluzione.....	22
Rekomandime	24

1. HYRJE

Raporti studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor” kryhet në kuadër të projektit “Përballja e Ofertave Politike – POP”. Ajo është një nismë e rrjetit të 12 organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe nga National Endowment for Democracy.

Gjatë vitit 2019 janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë) dhe që prej atij viti rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” monitoron zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Në vitin 2021, Rrjeti POP u zgjerua duke shtuar edhe bashkitë Elbasan, Vau i Dejës dhe Korçë. Tre Kontrata Sociale u nënshkruan në bashkitë e mësipërme duke vijuar kështu monitorimin për zbatimin e tyre në 12 bashki. Nëpërmjet këtij projekti Rrjeti POP, synon të forcojë bashkëpunimin me qytetarët në përfshirjen e tyre në vendimmarrje në nivel vendor, duke qenë një urë lidhëse mes tyre (qytetarëve) dhe pushtetit vendor për sa i përket transparencës, llogaridhënies dhe demokracisë vendore.

Organizatave të Rrjetit POP gjatë periudhës maj -qershor 2022 realizuan pyetësorë me stafet përkatëse në Bashki dhe me përfaqësues të Këshillave Bashkiakë dhe përgjigjet e marra nga pyetësorët u përballën me analizën e bërë nga vetë shoqatat sa i përket gjendjes aktuale në secilën bashki në lidhje me menyrën se si realizohet dhe mjetet e format që bashkitë përdorin për njoftimin, informimin dhe konsultimin e publikut.

Kjo analizë tregoi që bashkitë i vlerësojnë këto procese dhe përipiqen të përdorin mjete dhe forma të ndryshme për të patur qytetarët dhe qytetarët pjesë të veprimtarisë dhe vendimmarrjes së tyre por ka dhe sfida që duhen tejkaluar e mangësi të cilat duhen përmirësuar.

Për shembull faqet zyrtare të bashkive duhen të jenë më miqësore për publikun, regjistri i kërkesë ankesave duhet të përditësohet vazhdimisht, programet e transparencës duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të konsultohen me qytetarët, bashkitë duhet të përdorin një numër të konsiderueshëm mjetesh dhe formash për njoftimin dhe informimin e qytetarëve. Proceset e konsultimeve realizohen në bashkitë pjesëmarrëse por më shumë duhet të punohet për rritjen dhe nxitjen e interesit të qytetarëve për të marrë pjesë dhe për t’u përfshirë në sa më shumë takime e dëgjesa publike, përfshirë procesin e hartimit të projekt-buxheteve.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve rrjeti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Është një përpjekje për të rritur hapësirat për debate publike dhe informacione të qytetarëve në lidhje me platformat e politikave nga njëra anë dhe duke i orientuar këto platforma drejt nevojave dhe përparësive të komunitetit nga ana tjetër.

Organizatrat partnere të rrjetit janë: Qendra “Aleanca Gjinore për Zhvillim” Tiranë; Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës; Qendra Rinore Vlorë; Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz; Epoka e Re, Fier; Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër; Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë; Qendra Rinore për Progres, Kukës, Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec, Gruaja në Zhvillim Korçë; Tjetër Vizion Elbasan dhe Qendra “Hapa të Lehtë” Vau i Dejës.

2. LISTA E SHKURTIMEVE

BP	Buxhetimi me Pjesëmarrje
BPGJ	Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinnor
KB	Këshilli Bashkiak
KKQV	Komisione Këshillimore Qytetare Vendore
GADC	Gender Alliance Development Center
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NED	National Endowment for Democracy
NJVQV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OPIC	Olof Palme International Centre
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
QV	Qeverisje Vendore
RAT	Reforma Administrativo-Territoriale

3. PROFILI I BASHKISË KORÇË

Që prej Reformës Administrativo-Territoriale të vitit 2015, Bashkia Korçë përbëhet nga 8 njësi administrative, të cilat janë: Korçë Qendër, Bulgarec, Voskop, Voskopojë, Lekas, Vithkuq, Mollaj dhe Drenovë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Korçës dhe Qarkut Korçë. Bashkia ka nën administrimin e saj 1 qytet dhe 62 fshatra. Sipërfaqja e Bashkisë Korçë është 805.99 km² dhe popullsia kap shifrën 130,531 banorë.

Qyteti i Korçës është një nga qytetet kryesore të Shqipërisë me një ekonomi të konsoliduar dhe biznese të shumta. Zonat rurale të bashkisë merren kryesisht me bujqësi, pemëtari dhe blegtori. Pjesë e bashkisë janë edhe disa fshatra turistike, në të cilat zhvillohet turizëm malor. Banorët ofrojnë ambiente akomoduese dhe shërbim, por edhe aktivitete dimërore si një atraksion i shtuar për turistët.

Njësitë administrative financohen nga të ardhurat që sigurohen nga taksat, tarifrat dhe të ardhurat e tjera vendore, nga fondet e transferuara nga buxheti i shtetit dhe fondet që u vijnë drejtpërdrejt nga ndarja e taksave e tatimeve kombëtare, huamarrja vendore, donacionet, si dhe burime të tjera të parashikuara në ligj.

Struktura e Administratës së Bashkisë Korçë është si në vijim: 21 pozicione funksionare politike; 181 pozicione nëpunës civilë; 162 pozicione punonjës administrativë. Këshilli Bashkiak përbëhet prej 41 anëtarësh.

Niveli i Transparencës në Bashkinë Korçë

Aktorë të ndryshëm kanë arritur të bëjnë monitorime, matje dhe vlerësime mbi nivelin e transparencës në nivel vendor. Edhe Bashkia Korçë ka qënë pjesë e këtyre monitorimeve, të cilat kanë nxjerrë në pah arritjet dhe problematikat e hasura, si dhe kanë bërë një krahasim të punës së saj me bashkitë e tjera. Disa të dhëna që kanë të bëjnë me nivelin e transparencës së Bashkisë Korçë referuar raporteve të vlerësimit janë:

- Udhëzuesi mbi Transparencën dhe Pjesëmarrjen Qytetare në Shqipëri, hartuar nga Kongresi i Autoriteteve Vendore dhe Rajonale të Këshillit të Evropës dhe organizata Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim më [2018] e vlerëson Bashkinë Korçë si një ndër bashkitë më progresive në lidhje me zbatimin korrekt të kuadrit ligjor rregullator në lidhje me aksesin në informacion.¹

¹ Shqipëria Udhëzues mbi Transparencën dhe Pjesëmarrjen Qytetare.2018

- Bashkia Korçë ka rezultuar bashkia më transparente në vend për vitin 2017 sipas raportit të Qendrës për Çështje të Informimit Publik (INFOÇIP) në pesë tregues: 1) Faqe interneti zyrtare; 2) Regjistri i pyetjeve e përgjigjeve; 3) Koordinatorin për të drejtën e informimit; 4) Publikimi i vendimeve të Këshillit Bashkiak; 5) Hartimi dhe publikimi i programit të transparencës (INFOÇIP, 2017).²
- Sipas monitorimit online të faqeve të internetit të bashkive në Shqipëri të kryer nga Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Investigative, Bashkia Korçë renditet e para ndër të gjitha bashkitë për vitin 2017, me një nivel të transparencës prej 69% (BIRN, 2017)³. Kategoritë më transparente në Bashkinë e Korçës janë transparenca financiare, zbatimi i së drejtës për informim dhe publikimi i mbledhjeve dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak.
- Sipas një studimi të realizuar nga Qendra për Çështjet e Informimit Publik, INFOÇIP (2019), për implementimin e ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” në nivel të qeverisjes vendore, Programi i Transparencës i Bashkisë Korçë është cilësuar më i miri në Shqipëri për vitin 2018.⁴
- Raporti i monitorimit “Pushteti vendor nën lanten e të drejtës për informim” përgatitur nga BIRN Albania, nga vlerësimi krahasues i treguesit të transparencës në terren dhe online për 61 bashkitë e vendit për vitin 2019, e rendit Bashkinë Korçë të dytën për nivelin e transparencës proaktive online (65%), pas Bashkisë Shkodër.⁵
- Sipas raportit të përgatitur dhe publikuar nga Qendra Res Publica në shtator 2019, në lidhje me indeksin e transparencës proaktive, Bashkia Korçë vlerësohet me 49 pikë duke qëndruar në renditje pas Bashkive Shkodër, Elbasan dhe Durrës. Bashkia Korçë në raport nuk përmendet si institucion që ka pësuar progres ose regres të ndjeshëm.⁶
- Sipas raportit të përgatitur nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) në vitin 2021, “Transparenca dhe Llogaridhënia në nivelin e qeverisjes vendore”, mbështetur në monitorimin e dokumentacionit të publikuar në Programin e Transparencës në 10 bashki të vendit, Bashkia Korçë rezultoi në grupin “Transparencë pjesërisht e lartë” (Durrës, Korçë, Fier). Në këtë monitorim vetëm një bashki i përkiste kategorisë “Transparencë e lartë” (Shkodër).⁷

² INFOCIP.2017.Monitorimi 2017-Implementimi i të drejtës së informimit nga Bashkitë e Shqipërisë.Tiranë

³ INFOCIP.2017.Monitorimi 2017-Implementimi i të drejtës së informimit nga Bashkitë e Shqipërisë.Tiranë

⁴ INFOCIP.2017.Monitorimi 2017-Implementimi i të drejtës së informimit nga Bashkitë e Shqipërisë.Tiranë

⁵ INFOCIP.2017.Monitorimi 2017-Implementimi i të drejtës së informimit nga Bashkitë e Shqipërisë.Tiranë

⁶ INFOCIP.2017.Monitorimi 2017-Implementimi i të drejtës së informimit nga Bashkitë e Shqipërisë.Tiranë

⁷ IDM.2021. Monitorimi 2021- Vlerësimi i Transparencës dhe Llogaridhënies në nivelin e qeverisjes vendore.

4. METODOLOGJIA

Për hartimin e raportit mbi situatën e informimit, njoftimit dhe konsultimit publik në Bashkinë Korçë janë kërkuar dhe përdorur një seri teknikash dhe instrumentash, të tilla si: a) hartimi i metodologjisë dhe instrumentit të anketimit (dy pyetësorë); b) kërkim dhe analizim të informacionit, dokumentave (fizikë dhe elektronikë) dhe kuadrit rregullator e ligjor përkatës; c) intervista të thelluara me stafin e bashkisë dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak; d) analizim dhe përpunim të të dhënave të anketimit dhe e) përgatitja e raportit së bashku me rekomandimet përkatëse.

Ekspertët e projektit e bazuan procesin e kërkimit dhe analizimit në tërësinë e informacionit, dokumentacionit dhe praktikave, të përdorura në procese të ndryshme të njoftimit, informimit, konsultimit dhe angazhimit të komunitetit në bashkëqeverisje dhe vendimmarrje. Procesi i kërkimit dhe analizimit u shtri si në dokumencionin ekzistues zyrtar, ashtu edhe në kuadrin respektiv rregullator e ligjor, të tilla si Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, etj. Identifikimi dhe analiza e burimeve ekzistuese tregoi se ka pak informacion dhe të dhëna të disonueshme mbi praktikën e njoftimit dhe përfshirjes qytetare në qeverisjen vendore.

Pamjaftueshmëria e informacionit të disponueshëm mbi çështjen në fjalë, theksoi rëndësinë e procesit të anketimit me të gjithë hallkat e veta (hartimi i metodologjisë, përcaktimi i rubrikave dhe informacionit që duhej mbledhur dhe analizuar, si dhe format e mjetet që do të përdoren për kryerjen e tij). Metoda kryesore për realizimin e studimit është ajo sasiore, që nënkupton përdorimin e pyetësorëve për mbledhjen e të dhënave. Anketimi përdori gjerësisht elemente të vlerësimit cilësor nëpërmjet pyetjeve të hapura dhe shpjeguese, me qëllim eksplorimin e instrumenteve dhe proceseve që sigurojnë angazhim dhe gjithëpërfshirje të komuniteteve në pushtetin vendor. Metodologjia e studimit mbar elementë të fortë të vlerësimit informativ.

Pjesë e këtij anketimi janë bërë drejtues, stafe teknike dhe këshilltarë vendorë të 12 bashkive të madhësive të ndryshme të përfshira në programet shumëvjeçare që Olof Palme ka zbatuar në vend. Për anketimin u hartuan dy pyetësorë me pyetje shteruese cilësore dhe sasiore, të cilat mbulojnë një gamë të gjerë temash dhe çështjesh. Për përgatitjen e pyetësorëve u konsultuan paraprakisht ligjet, rregulloret dhe udhëzimet përkatëse, që përbëjnë kuadrin ligjor dhe institucional mbi informimin, njoftimin dhe konsultimin qytetar në nivel vendor.

Faza përmbyllëse përfshiu hedhjen, përpunimin statistikor, studimin dhe analizimin e të dhënave, si dhe përgatitjen e këtij raportit përfundimtar.

5. ANALIZË E FORMAVE TË NJOFTIMIT, INFORMIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK

Komunikimi i vazhdueshëm ndërmjet institucioneve publike dhe qytetarëve është një ndër elementët kryesorë për të krijuar një marrëdhënie të mirë mes institucionit dhe publikut. Bashkia Korçë përdor mjete dhe forma të ndryshme për të komunikuar me qytetarët.

Zyra me Një Ndalesë

Zyra me Një Ndalesë është kontakti i parë me qytetarët sapo futen në Bashki. Në këtë zyrë punonjësit merren me problematikat dhe çështjet e qytetarëve duke i drejtuar ato në strukturat përkatëse për zgjidhje. Zyra me Një Ndalesë quhet ndryshe edhe Zyra e Informacionit, ku bëhen kërkesa apo shkresa për informim. Shërbimet e Zyrës me Një Ndalesë lehtësojnë marrëdhënien e qytetarëve dhe bizneseve për grupe shërbimesh administrative të ndryshme si: vërtetime, kërkesa, ankesa, aplikime për leje dhe autorizime të ndryshme, marrje informacioni etj.


Gjatë aktiviteteve që shoqata “Gruaja në Zhvillim Korçë” ka realizuar me grupe qytetarësh ata janë shprehur se janë të kënaqur nga pritja dhe disponibiliteti që demostrojnë nëpunësit e kësaj zyre, për ti ndihmuar ata, duke iu ofruar gjithë informacionin e nevojshëm.

Rrjeti Social Facebook

Faqja zyrtare Facebook e Bashkisë Korçë, të cilën institucioni e përdor si një platformë komunikimi dhe informimi për qytetarët, ka 26,836 ndjekës. Nga monitorimi që është bërë rezulton se i kushtohet vëmendje kryesisht aktiviteteve kulturore, artistike, sportive dhe aksioneve që lidhen me punën e bashkisë.

Mesatarisht në këtë faqe rezultojnë 10 postime në javë dhe mesatarisht 40 postime në muaj. Prej tyre rreth 72% përbëjnë informacione për aktivitetet artistike, kulturore, sportive dhe 28% informacione të tjera të rëndësishme. Kjo përqindje ndryshon nga muaj në muaj dhe rezultojnë muaj që ky raport është edhe 64% me 36% në favor të aktiviteteve artistike, kulturore, sportive.

Gjithashtu në të publikohen thirrje në lidhje me iniciativa të ndryshme. Kjo synon dhënien e mundësive për punësim nëpërmjet programeve të trajnimit, të cilat nxisin gjenerimin dhe zbatimin e ideve të reja sidomos nga të rinjtë. Në këtë faqe gjenden edhe njoftimet e ftesat për mbledhjet e Këshillit Bashkiak dhe konsultimet publike me banorët dhe grupet e interesit.



Në faqen zyrtare Facebook të Këshillit Bashkiak postohen regullisht njoftimet për mbledhjet e Këshillit Bashkiak, në përgjithësi 6 ditë para mbledhjes. Njoftimet janë të shoqëruara me datën, orën, vendin e takimeve edhe me rendin e ditës. Mbledhjet e Këshillit Bashkiak shfaqen të plota dhe direkt në këtë faqe zyrtare. Gjithashtu, aty publikohen ftesat për konsultime publike me banorët dhe grupet e interesit.

Faqja Web e Bashkisë



Bashkia Korçë, si shumë institucione të tjera zotëron një faqe web-i, <https://www.bashkiakorce.gov.al/site/>. Kjo faqe shërben për dhënien e informacionit në formën e shkruar dhe shihet si një nga mënyrat me të cilën bashkia komunikon me qytetarët. Nga kjo faqe qytetarët mund të marrin informacione të ndryshme për: bashkinë, programin e transparencës, shpallje apo njoftime, informacione rreth Korçës, etj.

Programi i Trasparencës

Në faqen web të Bashkisë Korçë ndodhet Programi i Trasparencës. Gjithsesi, ky program do të ishte më lehtësisht i identifikueshëm nga qytetarët nëse do të ishte pozicionuar tek rubrikat kryesore të menuesë së këtij web-i. Ndodhet në këtë faqe me emrin “Programi i Trasparencës”. Kjo platformë është e lehtë për t’u përdorur dhe e mirëstrukturuar, si edhe shpjegohet më poshtë:

Fusha I: Mbi organizimin dhe funksionimin e bashkisë

Kjo fushë është e organizuar në 7 nënfusha, të cilat përmbajnë informacion të bollshëm dhe të përditësuar. Nga monitorimi i kësaj fushe rezulton se :

- Shumica e dokumentacioneve të kërkuara janë lehtësisht të aksesueshme dhe të përdorshme për qytetarin. Ato mund të shkarkohen dhe të kopjohen lehtësisht.
- Publikimi i Vendimeve të Këshillit Bashkiak (VKB) bëhet në mënyrë të plotë dhe të përditësuar, dhe gjendet lehtësisht vetëm me dy klikime edhe në platformën kombëtare VENDIME.AL.
- Në rubrikën “Njoftime” tek Programi i Trasparencës, ndodhen vetëm dy të tilla: *Njoftimi për konsultimin me projekt-buxhetin e vitit 2022* dhe *Njoftim për publikimin e sondazhit online (2022)*. Njoftimet e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak bëhen nëpërmjet një linku në këtë rubrikë, i cili të çon për të marrë informacionin e kërkuar tek faqja zyrtare e bashkisë. Gjithashtu këto njoftime bëhen nëpërmjet postimeve në faqen Facebook të Këshillit Bashkiak.
- Orari i pritjes së qytetarëve ndodhet online.
- Mungon adresa elektronike e Njësive Administrative në varësi të bashkisë. Numrat telefonikë të Njësive Administrative gjenden jashtë rubrikave të Programit të Trasparencës.
- Ka një nënfushë “Njoftime” mbi vende të lira pune dhe procedurat e rekrutimit, e cila me një klikim të çon tek menuja “Njoftime” e faqes web <https://www.bashkiakorçe.gov.al/site/> , ku postohen ato.
- Informacioni mbi adresat postare dhe elektronike të institucioneve në varësi të bashkisë nuk është lehtësisht i arritshëm, për faktin se nuk ndodhet i organizuar në një dokument të vetëm, brenda Programit të Trasparencës.
-

- Dokumentacioni i nënfushës 4, mbi procedurat e bërjes së kërkesave, ankesave dhe vërejtjeve lidhur me veprimet ose mosveprimet e organeve dhe administratës, gjendet në fushën 3 “Kërkesa për informim”
- Tek nënfusha 6 e Programit të Transparencës nuk gjenden dokumente mbi procedurat e kërkesave, ankesave, peticioneve. Këtu gjenden dokumente në lidhje me ligjshmërinë, rregullore të ndryshme dhe vetëm dy tip formularësh: 1) Formular i sinjalizimit të brendshëm “të një veprimi ose praktike të dyshuar korrupsioni”, 2) Formular kërkesë për mbrojtje nga hakmarrja. Formate të tjera të standardizuara për kërkesa dhe ankesa mundet të gjenden jashtë Programit të Transparencës në faqen web të Bashkisë.
- Vërehet se nuk ka informacion në lidhje me peticionet në këtë fushë. Një informacion i shkurtër gjendet tek Fusha VI: Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje, nënfusha; Iniciativa qytetare. Gjithsesi, procedurat se si realizohet një petition mungojnë.

Fusha II: Transparenca dhe llogaridhënia ekonomiko-financiare

- Informacioni i 9 nënfushave përgjithësisht është i plotë, i kuptueshëm, dhe i përditësuar. Shumica e dokumenteve gjenden në formatin pdf, i cili lejon shkarkimin dhe kopjimin e informacionit.
- Mungon informacioni lidhur me shitjen, ose dhënien me qira të pronave dhe asetëve. Ndodhet një dokument ku pasqyrohen vetëm kriteret për marrjen me qira.
- Mungojnë të dhënat në lidhje me donacionet, shumën dhe qëllimin e tyre. Ky informacion mund të gjendet jo i plotë në rubrika të tjera të faqes zyrtare të web-it të bashkisë, jashtë Programit të Transparencës.

Fusha III: Kërkesat për informim

- Përgjithësisht, informacioni i kësaj fushe është i plotë, duke përfshirë të gjitha dokumentet e nevojshme, i përditësuar, i kuptueshëm dhe lehtësisht i përdorshëm.
- Ka të dhëna të plota mbi Koordinatorin për Informim, si dhe për standardet dhe procedurat që duhen ndjekur për të bërë kërkesë për informim dhe ankimim.
- Është ruajtur anonimat i emrit të individit, apo organizatës që bën kërkesë për informim dhe ankimim.

- Gjendet e paplotësuar kolona e objektit në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve për vitet 2019 dhe 2020, është pjesërisht e plotë për vitet 2015- 2018 dhe e plotë për vitet 2021-2022.
- Po ti referohemi regjistrin elektronik për vitin 2022, rezulton se është rregullisht i perditësuar dhe funksional. Gjejmë në këtë regjistër të publikuara 14 kërkesa me përgjigjet përkatëse dhe 79% e përgjigjeve janë dhënë brenda një afati kohor 1-2 ditë pune nga data e dorëzimit të kërkesës.
- Informacioni i dhënë në tabelat përmbledhëse në lidhje me kërkesat për informim nuk ju krijon mundësi personave të tjerë që të mund ta kërkojnë atë në të ardhmen.

Fusha IV: Shërbimet që ofron bashkia

- Informacioni i dhënë është i shkruar qartë dhe i kuptueshëm për të gjithë. Ai është lehtësisht i përdorshëm.
- Nuk ka dokumente të paraqitura në format standard dhe të organizuara në fusha sipas funksioneve të përcaktuara me ligj.

Fusha V: Legjislacioni dhe aktet e brendshme rregullatore

- Shumë mirë janë paraqitur publikimet e ligjeve, kodeve dhe konventave të ratifikuara nga vendi ynë.
- Legjislacioni i perditësuar i pushtetit zgjedhor gjendet i publikuar jashtë Programit të Transparencës, në një rubrikë të veçantë të faqes zyrtare të web-it të bashkisë.
- Paraqitet më i vështirë kërkimi i informacionit në lidhje me vendimet, urdhëresat dhe urdhrat e Kryetarit të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak, pasi nevojiten më shumë shfletime në rubrikat e tjera të faqes zyrtare.
- Një pjesë e vendimeve, urdhrave dhe urdhëresave të Kryetarit të Bashkisë, gjenden jashtë Programit të Transparencës.
- Mungojnë dokumente politike vendore.

Fusha VI: Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje

- Mungon një plan vjetor i detajuar për procesin e vendimmarrjes me pjesëmarrje.
-

- Gjenden publikime të kalendareve të konsultimeve publike, në të cilat ka vetëm të dhëna mbi datën, objektin dhe personat përgjegjës.
- Njoftimet për procesin e konsultimit publik gjenden të publikuara tek Programi i Transparencës.
- Informacionet mbi takimet publike janë të përditësuara.
- Është prezent lista e akteve për të cilat është e detyrueshme të zhvillohet konsultimi publik.

Fusha VII: Informacion tjetër

- Qytetari mund të gjejë të dhëna mbi projekte, nisma dhe veprimtari të bashkisë në kuadrin e integritetit në BE, ose nisma advokuese, lobuese nga shoqëria civile.
- Gjenden raporte, studime dhe vlerësime mbi zbatimin e Programit të Transparencës nga aktorë jashtë institucionit të bashkisë.
- Ka të dhëna mbi OJF-të, përfaqësuesit e medias dhe biznesit.
- Ka të dhënat mbi strukturat komunitare në fshat dhe qytet.

Komunikimet e drejtpërdrejta

Komunikimi i drejtpërdrejtë është një nga mënyrat më të përdorura. Komunikimin ballë për ballë Bashkia Korçë e realizon përmes dëgjësave publike të cilat zhvillohen në ditë të caktuara, për problematika apo çështje që kanë qytetarët.

6. GJETJET NGA ANKETIMI ME PËRFAQËSUES TË BASHKISË E KËSHILLIT BASHKIAK

Kuadri ligjor në fuqi parashikon një sërë detyrimesh dhe përgjegjësish në lidhje me format dhe mjetet që institucionet publike duhet të venë në dispozicion për të krijuar dhe mundësuar pjesëmarrjen e publikut dhe grupeve të interesit në procesin e informimit, njoftimit dhe përfshirjes së tyre në konsultim e vendimmarrje.

Për të parë ecurinë e këtyre proceseve në respekt edhe detyrim të ligjit dhe qytetarëve, u zhvillua një anketim me 13 përfaqësues të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak Korçë. Anketimi synon të evidentojë dhe sjellë në vëmendje situatën aktuale të pjesëmarrjes qytetare në proceset konsultuese dhe vendimmarrëse si dhe të analizojë të gjitha

format dhe instrumentat që institucioni i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak përdorin për sjelljen më pranë të qytetarëve në bashkëqeverisje.

Shtatë të intervistuarit nga Këshilli Bashkiak janë anëtarë të komisioneve të ndryshme, përfshirë edhe Kryetarin dhe Sekretarin e Këshillit. Ata përfaqësonin: Komisionin e Mirëqënies Sociale, Strehimit, Rinisë, Barazisë Gjinore, Mosdiskriminimit të të Drejtave të Njeriut; Komisionin e Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë dhe Mbikqyrjes Financiare.

Gjashtë të intervistuarit nga institucioni i Bashkisë mbulojnë detyra dhe procese që lidhen me qytetarët (qoftë edhe jo drejtpërdrejtë), të tilla si strukturat përgjegjëse për marrëdhëniet me publikun/qytetarët, njoftimin dhe konsultimin publik, të drejtën e informimit, shëfria e Kabinetit të Kryetarit të Bashkisë dhe administratorë të NJA-ve.


Njoftimi, Informimi dhe Konsultimi në Vendimmarrjen Vendore

Të pyetur se sa i rëndësishëm është njoftimi, informimi dhe konsultimi në vendimmarrjen vendore, rezulton që 100% e të 13 të intervistuesve kanë bindjen se këto procese janë shumë të rëndësishme.



Kuadri Ligjor për Njoftimin, Informimin dhe Konsultimin në Nivel Vendor

Pyetjes se sa të intervistuarit njohin bazën ligjore për njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimmarrjen vendore, të gjithë të intervistuarit këshilltarë të Këshillit Bashkiak i janë përgjigjur se e njohin shumë mirë.




Po t'u referohemi përgjigjeve që kanë dhënë për këto pyetje drejtues dhe nëpunës të bashkisë, kemi ndryshime në përqindje. Vetëm 66.7% e tyre janë përgjigjur që e njohin shumë mirë bazën ligjore për njoftimin, informimin dhe konsultimin. 16.7% Mirë dhe 16.7% Disi.


Bazuar në përgjigjet e të intervistuarve rezultojnë që pjesa më e madhe e njeh shumë mirë bazën ligjore për njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimarrjen vendore. Duke iu referuar intervistave, vetëm administratorë të NJA-ve jashtë zonës urbane kanë vështirësi në njohjen e bazës ligjore dhe për këtë arsye konsultohen për raste specifike me zyrën juridike të institucionit të bashkisë për të qenë korrekt me ligjin.



Në lidhje me vlerësimin që anëtarët e Këshillit Bashkiak kanë bërë për kuadrin ligjor mbi njoftimin dhe informimin e publikut në nivel vendor, vetëm 85.7% e përcaktojnë të qartë dhe të plotë dhe 14.3% si të qartë por jo të plotë.



Po t'u referohemi grafikëve të mëposhtëm vihet re që rezultatet në lidhje me këtë vlerësim janë të përafërta edhe me ato të intervistuarve drejtues dhe nëpunës të Bashkisë, prej të cilëve, 83.3% e vlerësojnë të qartë dhe të plotë dhe 16.7% të qartë, por jo të plotë.




Disa prej opinioneve të drejtuesve dhe nëpunësve të Bashkisë në lidhje me bazën ligjore janë se ajo është e qartë por çalohet në zbatimin e saj, apo se ligjet janë të mirëformuluara, po jo të zbatueshme praktikisht.

Koordinatori për Njoftimin, Konsultimin Publik dhe Transparencën



Në Bashkinë Korçë, Drejtoresha e Marrëdhënieve me Publikun dhe Informimin qytetar kryen njëkohësisht edhe funksionet e Koordinatorës së të Drejtës për Informim dhe të Koordinatorës për Njoftim dhe Konsultim Publik. Nga intervistat e nëpunësve të Bashkisë jo të gjithë kanë informacion në lidhje me këtë.

Koordinatori për njoftimin dhe konsultimin publik parashikohet nga dy ligje dhe një Vendim i Këshillit të Ministrave. Konkretisht, ligji 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, ligji nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe VKM Nr. 828, datë 7.10.2015, “Për Miratimin e Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrimit Elektronik për njoftimet dhe Konsultimet Publike. Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik sipas ligjit ka një rol të rëndësishëm, në procesin e realizimit të njoftimeve dhe konsultimeve publike dhe me detyra të përcaktuara qartë.




Të dhënat e Koordinatorit për Njoftimin dhe Konsultimin Publik duhet të afishohen publikisht në faqen zyrtare të Bashkisë. Nga monitorimet e kryera, të dhënat e Koordinatorit janë publikuar tek Programi i Transparencës, specifikisht tek Fusha

“Pjesëmarrja qytetare në vendimmarrje”.

Instrumentat për Lajmërimin dhe Njoftimin e Qytetarëve

Ligji 146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” parashikon një sërë detyrimesh dhe përgjegjësish në lidhje me format dhe mjetet që institucionet publike duhet të venë në dispozicion për të krijuar dhe mundësuar pjesëmarrjen e publikut dhe grupeve të interesit në procesin e njoftimit e përfshirjen e tyre në konsultim dhe vendimmarrje.

Sipas drejtuesve dhe nëpunësve të Bashkisë mjetet më të përdorura që përdoren për informimin e qytetarëve janë:




- Këndet e informimit në Bashki - 100%
- Mediat sociale 100%
- Lajmërimet në faqen e Bashkisë - 83.3%
- Materialet informuese - 83.3%
- Botime të Bashkisë - 66.7%
- Regjistri elektronik - 50%
- Zyrat me një Ndalesë - 33%
- Mediat audio-vizive lokale - 33.3%


Anëtarët e intervistuar të Këshillit Bashkiak duke njohur rëndësinë dhe fuqinë e përhapjes së lajmit përmes mediave sociale në ditët e sotme, cilësojnë si mjetin më të përdorur lajmërimet përmes mediave sociale (Facebook, etj). Sipas tyre më i përhapur se të tjerët është lajmërimi përmes takimeve direkte dhe thirrjeve telefonike, sidomos për zonat rurale dhe grupmoshën e tretë.

Vlerësimet e tyre për pyetjen janë si më poshtë:

- Lajmërimet në mediat sociale - 100%
- Lajmërimet individuale - 43%
- Këndet e informimit në Bashki - 28.6%
- Mediat audio-vizive lokale - 28.6%
- Posta elektronike/email - 28.6%



Aksesi ndaj Dokumentave dhe Informacioneve Zyrtare



Rezultatet e anketës sugjerojnë që qytetarët e Bashkisë Korçë mundet të aksesojnë lehtësisht informacione dhe dokumente si duke u paraqitur fizikisht pranë institucionit, ashtu edhe duke shkarkuar aktet e Bashkisë në faqen zyrtare të internetit. Të gjithë të intervistuarit shprehen që aktet publikohen në faqen web të Bashkisë. Të gjithë të intervistuarit, si anëtarët e Këshillit Bashkiak edhe ata nga administrata, në masën 100% kanë bindjen se qytetarët kanë mundësi t'i aksesojnë dokumentet pranë institucionit ose nëpërmjet internetit. Sipas tyre një pjesë të këtyre akteve mundet t'i gjejnë në vendet e caktuara për njoftimet publike.

Të pyetur nëse aktet e Bashkisë bëhen prezentë për publikun e gjërë, 83% e këshilltarëve konfirmojnë që aktet e Bashkisë afishohen në vendet e caktuara për njoftimet publike.



Nga vëzhgimi që stafi i shoqatës “Gruaja në Zvillim Korçë ka bërë në këto stenda rezulton se njoftimet janë të update-uara. Ato qëndrojnë në stendë për të gjithë afatin kohor të përcaktuar me ligj(40, 30, 15...ditë).

Programi i Transparencës



Duke iu referuar përgjigjeve të anëtarëve të Këshillit Bashkiak të intervistuar në këtë anketim në lidhje me Programin e Transparencës, të gjithë e njohin këtë program. Nuk ka vendim të Këshillit Bashkiak për miratimin e Programit të Transparencës. Qytetarët mundet të

aksesojnë dokumente dhe informacione që iu duhen nëpërmjet Programit të Transparencës të Bashkisë Korçë, i cili është i lehtë për t'u përdorur dhe i mirëstrukturuar. Dokumentacioni që ndodhet në këtë program është lehtësisht i përdorshëm, pasi mund të shkarkohet dhe të printohet.

Nga diskutimet me qytetarët shumë pak prej tyre kanë informacion në lidhje me Programin e Transparencës dhe shumica preferon të marrë informacion në mënyrë të drejtpërdrejtë.

Regjistri Elektronik

Në Programin e Transparencës ndodhet edhe Regjistri Elektronik i Kërkesave dhe Ankesave në vite dhe sidomos në dy vitet e fundit vihet re një përmirësim i dukshëm i këtij regjistri. Gjenden informacione jo vetëm mbi objektin e kërkesës apo ankesës së bërë, por edhe përgjigjet dhe datat përkatëse.

Po t'i referohemi Regjistrin Elektronik për vitin 2022, rezulton se është rregullisht i përditësuar dhe funksional. Gjejmë në këtë regjistër të publikuara 14 kërkesa me përgjigjet përkatëse dhe 79% e përgjigjeve janë dhënë brenda një afati kohor 1-2 ditë pune nga data e dorëzimit të kërkesës.

Por kur pyetjet i referohen Regjistrin Elektronik, vihet re se jo të gjithë janë të informuar për të. Siç vihet re nga grafikët e mëposhtëm vetëm 57% e këshilltarëve (grafiku majtas) janë në dijeni të tij dhe pjesa tjetër ose nuk e di ose mendon që nuk ekziston fare. Kjo përqindje është akoma më e ulët nëse iu referohemi përgjigjeve nga drejtuesit dhe nëpunësit e Bashkisë (grafiku djathtas).




Vetëm 1/3 e të intervistuarve nga administrata kanë informacion për Regjistrin Elektronik dhe shprehen se ai përditësohet rregullisht. Po kaq në masë të barabartë, të intervistuarit shprehen se nuk e kanë idenë ose mendojnë që Regjistri Elektronik nuk ekziston fare. Pjesa tjetër ose nuk e bën dot lidhjen mes kërkesë-ankesave dhe Regjistrit, ose mendon që korrespondenca më parë bëhej online, por momentalisht informacioni përcillet vetëm përmes shkresave.

Raportet e Transparencës

Nga monitorimi i Programit të Transparencës rezulton që raportet vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes nuk janë hartuar dhe publikuar. Shumica e të intervistuarve nuk ka informacion në lidhje me këtë fakt.

Vetëm 42.9% e të intervistuarve nga Kwshilli Bashkiak janë të informuar se këto raporte vjetore nuk janë hartuar dhe publikuar dhe 57.1% shprehen JO.

Nëse iu referohemi të intervistuarve drejtues dhe nëpunës të bashkisë, raporti është 50% me 50%.



Bashkëpunimi mes Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë

Pyetjes se nëse ka bashkëpunim mes Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë për procesin e njoftimit dhe informimit, rreth 86% e këshilltarëve të intervistuar është përgjigjur PO. Por pyetjes se si realizohet ky bashkëpunim nuk i përgjigjen në mënyrë specifike. Në përgjithësi ata mendojnë se kjo realizohet nëpërmjet procedurave, njoftimeve, informimit për pjesëmarrjen e qytetareve në mbledhjet për buxhetimin me pjesëmarrje.



Dikush shprehet se bashkëpunimi kryhet në mënyrë institucionale përmes kërkesave zyrtare që Këshilli Bashkiak i drejton Bashkisë apo përmes Sekretares së Këshillit. Sekretaria ia përcjell sugjerimet e këshilltarëve Bashkisë ose komisioneve përkatëse, ku janë pjesëmarrës edhe punonjës nga Bashkia. Një këshilltar tjetër përgjigjet që kjo realizohet përmes shpërndarjes së materialeve me email dhe postë 5 ditë para mbledhjeve të Këshillit Bashkiak. Megjithatë, sipas tyre kërkohet më tepër bashkëpunim midis Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak.

8. KONKLUZIONE

Nga monitorimi, analiza e të gjitha medimeve, formave për informimin, njoftimin, konsultimin dhe analiza e rezultateve të të intervistuarve u konstatuan këto gjetje:

- 100% e të intervistuarve si nga institucioni i Bashkisë Korçë dhe Këshillit Bashkiak e vlerësojnë procesin e njoftimit, informimit dhe konsultimit publik si një proces shumë të rëndësishëm, shumë të nevojshëm, që kontribuon në rritjen e transparencës dhe pjesëmarrjes në procesin e vendimmarrjes së qytetarëve.
- Bazuar në përgjigjet e të intervistuarve, 1/3 e nëpunësve të Bashkisë Korçë kanë nevojë për një njohje më të mirë të bazës ligjore për njoftimin, informimin dhe

konsultimin në vendimmarrjen vendore dhe sidomos më tepër vështirësi vërehet tek administratorët nga zonat perurbane.

- Programi i Transparencës për Bashkinë Korçë do të ishte më lehtësisht i identifikueshëm nëse do të ishte pozicionuar tek rubrikat kryesore të menisë në faqen zyrtare të bashkisë <https://www.bashkiakorce.gov.al/site/>
- Programi i Transparencës pasqyron në mënyrë të plotë të gjithë legjislacionin e nevojshëm, përfshirë këtu aktet ligjore dhe nënligjore, dokumente politike kombëtare, rregullore, etj.
- Dokumentacioni që publikohet tek Programi i Transparencës përmban informacion të aksesueshëm për të gjithë qytetarët dhe është i mirëstrukturuar. Ai është lehtësisht i përdorshëm, pasi mund të shkarkohet dhe të printohet.
- Programi i Transparencës i përmban të 8 fushat e parashikuara sipas nenit 7 të ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, por një numër shumë i vogël informacionesh që duhet të ndodheshin në disa nënfusha të tij, si përshebull njoftimet për tenderim, gjenden të publikuara tek web-i i Bashkisë.
- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit janë të prezantuara në faqen web të Programi të Transparencës.
- Përgjithësisht janë publikuar në mënyrë të plotë si në formë, ashtu edhe në përmbajtje ato kategori informacioni që konsiderohen më “të lehta”, si dhe një pjesë e mirë e atyre që konsiderohen si informacione me natyrë më sensitive, siç është ai i lidhur me buxhetimet, financat, raportet e auditit.

Përsa i përket kategorisë së dytë të informacioneve u konstatuan këto informacione të munguara:

- Në prokurimet publike paraqitet objekti i prokurimit, si dhe vlera e kontratës, por mungon përmbajtja e saj.
- Po ashtu mungon informacioni në lidhje me publikimin e donacioneve, shumave dhe qëllimeve të tyre.
- Në Bashkinë Korçë, Drejtoresha e Marrëdhënieve me Publikun dhe Informimin Qytetar kryen njëkohësisht edhe funksionet e Koordinatorës së të Drejtës për Informim dhe të Koordinatorës për Njoftim dhe Konsultim Publik.

- Mungon adresa elektronike e Njësive Administrative në varësi të bashkisë. Numrat telefonikë të Njësive Administrative gjenden jashtë rubrikave të Programit të Transparencës.
- Nëse do t'i referoheshim Regjistrin Elektronik të Kërkesave dhe Përgjigjeve, vihet re një përmirësim vitet e fundit. Gjenden informacione jo vetëm mbi objektin e kërkesës, apo ankesës së bërë, por edhe përgjigjet dhe datat përkatëse.
- Tek Programi i Transparencës gjenden prezantime të organizatave, shërbimeve që ato ofrojnë, si dhe publikime të nismave advokuese, lobuese dhe monitoruese nga shoqëria civile.
- Nga monitorimi i Programit të Transparencës rezulton që raportet vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes nuk janë hartuar dhe publikuar

8. REKOMANDIME

Disa rekomandime të cilat do të ndikonin në rritjen e besueshmërisë të qytetarëve në transparencën e institucionit të Bashkisë dhe si rrjedhojë rritjen e angazhimit të tyre:

- Të punohet për gjetjen e mjeteve dhe mënyrave për informimin e publikut jo vetëm përmes mediave sociale, por edhe takimeve të drejtpërdrejta me qytetarët.
- Koordinatorin për Njoftimin dhe Konsultimin Publik ka një rol të rëndësishëm dhe me detyra të përcaktuara qartë në procesin e realizimit të njoftimeve dhe konsultimeve publike. Rekomandohet që ky pozicion të mbulohet nga një person.
- Të hartohen raporte vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes.
- Programi i Transparencës të pozicionohet tek rubrikat kryesore të menisë në faqen zyrtare të Bashkisë me qëllim që të identifikohet më lehtësisht nga kërkuesit.
- Të shtohen adresat elektronike të Njësive Administrative tek Programi i Transparencës. Numrat telefonikë të NjA-ve gjenden jashtë rubrikave të tij.

- Të përmirësohen dhe shtohen elementë të rëndësishëm për prokurimet publike dhe të pasqyrohet e publikohet informacioni në lidhje me donacionet, shumat dhe qëllimet e tyre tek Programi i Transparencës.
- Të ketë zyrë informimi edhe pranë Njësive Administrative.

Në lidhje me rritjen e kapaciteteve të punonjësve dhe këshilltarëve vendorë, rekomandohet realizimi i trajnimeve si më poshtë:

- Për rritjen e njohurive mbi kuadrin ligjor për njoftimin, informimin dhe konsultimin në nivel vendor për target grupet që kanë realisht nevojë.
- Për ndërtimin e marrëdhënieve reale midis organeve të zgjedhura, ekzekutive dhe qytetarëve për informim para dhe pasi të merren vendimet.
- Për buxhetet vendore, bërjen e tyre lehtësisht të lexueshëm dhe kuptueshëm nga të gjithë, si dhe prezantimin e thjeshtë për publikun në procesin e konsultimit.
- Për këshilltarët e ardhshëm, të trajnohen, sepse duhet të rrisin njohuritë dhe kapacitetet qysh në marrjen e mandatit të tyre.

Rrjeti "Përballja e Ofertave Politike – POP", synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga "Olof Palme International Center" dhe "National Endowment for Democracy." Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim", Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec;
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan